



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**Kodi i lëndës: INF 330**  
**Lënda: Infermiera speciale tek adulti**

PROGRAMI I LËNDËS									
Infermiera speciale tek adulti									
<b>Titullari i lëndës:</b>	Fatjona Kamberi PhD në Shkenca Infermiore _____								
<b>Ngarkesa:</b>	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	8 ECTS	45	0	0	60	1	106	94	200
<b>Tipologjia e lëndës</b>	Lëndë karakterizuese								
<b>Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda</b>	Viti III, Semestri II								
<b>Lloji i lëndës</b>	E detyruar								
<b>Programi i studimit</b>	Bachelor në "Infermieri të Përgjithshme"								
<b>Kodi i lëndës</b>	INF 330								
<b>Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës</b>	<a href="mailto:fatjona.kamberi@univlora.edu.al">fatjona.kamberi@univlora.edu.al</a>								

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Në këtë lëndë studenti pasi ka marë njohuritë përkatëse për patologjitë që prekin adultin në Sëmundje të Brendshme, Kirurgji dhe Geriatri, përgatitet në fushën e kujdesit infermior për të përballuar me sukses çdo situatë që i takon kësaj kujdesjeje.</p> <p>Mer njohuritë përkatëse për diagnozat infermiore si dhe protokolle të ndryshme të përkujdesjeve infermiore.</p>
<b>Objektivat e lëndës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Njohja me kujdesin infermior në patologjitë kryesore që prekin adultin.</li><li>▪ Paraqitja e vlerësimit infermior të pacientit.</li><li>▪ Njohja me protokollin e përkujdesjeve infermiore si dhe hartimin e diagnozave infermiore.</li></ul>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Të hartojnë diagnozat infermiore tek adultet.</li><li>▪ Të zbatojnë konkretisht protokollin e kujdesjeve sipas patologjite të sistemeve të ndryshme.</li><li>▪ Të prezantojnë rastet klinike të rëndësishme: nga etiologji deri tek plani i asistencës infermiore.</li><li>▪ Të realizojnë përkujdesjet infermiore në bazë të mendimit kritik.</li><li>▪ Të realizojnë administrimin e medikamenteve.</li><li>▪ Të njohin bazat fiziologjike të përkujdesjeve infermiore në çdo sëmundje.</li><li>▪ Të realizojnë teknikat e dhënies së ndihmës së parë.</li><li>▪ Të realizojnë kujdesin infermior në eliminimin urinar dhe intestinal.</li><li>☞ Të kujdesen për një plagë të pastër, të kontaminuar, të infektuar apo dhe për një dekubitus.</li></ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

### KONCEPTET THEMELORE

1. Bazat fiziologjike të kujdesjeve infermiere ne semundjet e brendshme
2. Përkujdesjet shëndetësore gjatë gjithë jetës. Promocioni shëndetësor dhe parandalimi i semundjeve tek adultet sipas sistemeve .
3. Administrimi i medikamente dhe ndihma psikologjike ndaj të sëmurëve me çrregullime kardiake, pulmonare, gastrointestinale, endokrine, hematologjike dhe renale.
4. Ndihma infermiere në semundjet geriatrike
5. Kujdesi infermior ne periudhen pre dhe postoperatore.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<b>Tema 1</b> - Metodatat e ekzaminimit ne kardiologji. Kujdesi infermior tek pacientet me TA dhe kriza hipertensive <i>Per diagnostikimin e semundjeve te aparatit kardiovaskular perdoret nje numer i madh metodash instrumentale, nga me te thjeshtat deri tek te nderlikuarat apo te sofistikuarat.</i> <i>Tension arterial quajme presionin qe ushtron gjaku ne enet e tij.Niveli i ketij presioni varet nga vellimi i gjakut, forca e punes se zemres dhe rezistenca periferike qe has rrjedha e gjakut ne sistemin arterial.HTA eshte nje nga semundjet me te perhapura ne te gjithe boten. Ne vendin tone ai prek rreth 80% te popullates se rritur.</i>	<sup>(1)</sup> f.q.8-14	Leksion 1 orë
	<b>Tema 2</b> - Kujdesi infermior tek pacientet me edemë pulmonare <i>Edema mushkërore (pulmonare) është një sindromë klinike me shkaqe të shumta etiologjike, që shoqërohet me grumbullimin e një sasive lëngu në indin pulmonar.</i>	<sup>(1)</sup> f.q.15-22	Leksion 1 orë
	<b>Tema 3</b> – Kujdesi infermior tek te semuret me endokardit, perikardit, miokardit. <i>Perikarditet janë inflamacione të cipave të perikardit.Ato janë sëmundje shumë shkakësore. Endokarditet janë inflamacione të cipave të endokardit.</i>	<sup>(1)</sup> f.q.23-33	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
II.	<b>Tema 4</b> - Kujdesi infermior tek te semuret me angina pektoris dhe te semuret me IAM. <i>Angina pektoris është nje patologji qe ndodh kur furnizimi me oksigjen ne zemer nuk eshte i mjaftueshem, zakonisht nga ndryshimet aterosklerotike ne arteriet koronare.</i> <i>Infarkti i miokardit është një patologji që shprehet me zona të nekrotizuara ne miokard, që vjen nga një spazëm e tejzgatur dhe nga obstrukcioni i arteries koronare në mungesë të qarkullimit kolateral dhe që con në ndalimin e menjëhershëm të gjakut dhe oksigjenit në muskulin kardiak.</i>	<sup>(1)</sup> f.q.34-40	Leksion 1 orë
	<b>Tema 5</b> - Kujdesi infermior ne kardiomiopati dhe ne insuficencen kardiake. <i>Insuficiencia kardiake është një gjendje kronike shumë e përhapur ku zemra e sëmurë ul aftësitë e një personi që të jetë mjaftueshmërisht aktiv nga ana fizike. Të kesh një insuficiencë kardiake do të thotë që gjaku nuk hidhet nga zemra në mënyrë të saktë dhe ndonjëherë shkakton një pengesë për gjakun që ndodhet në mushkëri dhe në indet e trupit.</i>	<sup>(1)</sup> f.q.48-52	Leksion 1 orë
	<b>Tema 6</b> - Kujdesi infermior ne te semuret me Pneumoni. <i>Pneumonia eshte proces inflamator i pulmoneve, i cili perqendrohet ne indin intersticial perialveolar dhe te mureve alveolare.</i>	<sup>(1)</sup> f.q.53-63	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
III.	<b>Tema 7</b> - Kujdesi infermieror ne pacientet me SPOK dhe ne trakeobronkit. <i>SPOK është sëmundja pulmonare obstruktive kronike. Observimi dhe historiku i sëmundjes, do të ndihmojnë infermierin në kuptimin e pacientit dhe sëmundjes së tij. Mbledhja e të dhënave përfshin sigurimin e informacionit rreth simptomave të vazhdueshme.</i>	<sup>(1)</sup> fq.65-76	Leksion 1 orë
	<b>Tema 8</b> – Kujdesi infermieror në asthmën bronkiale dhe në PNX. <i>Astma bronkiale është një gjendje klinike që shfaqet në formën e insuficiencës respiratore që vjen nga reaktiviteti i lartë i rrugëve trakeo-bronkiale ndaj faktorëve të ndryshëm ambientalë apo genetikë.</i> <i>PNX është grumbullimi i ajrit në hapësirën pleurale, që ndan mushkëritë nga muri i gjoksit.</i>	<sup>(1)</sup> fq.76-89	Leksion 1 orë
	<b>Tema 9</b> - Kujdesi infermieror në pleuritet sika dhe eksudativ dhe në Bronkitin akut. <i>Pleuriti është inflamacion i pleurës dhe grumbullim i likidit në hapësirën midis dy pleurave viscerale e parietale.</i> <i>Bronkiti Akut është inflamacion i mukozës së bronkeve që karakterizohet me ndryshime anatomo-patologjike dhe shprehet me shtim të sekrecioneve dhe ndjeshmërisë së tyre (exudat dhe spazma).</i>	<sup>(1)</sup> fq.90-93	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
IV.	<b>Tema 10</b> – Kujdesi infermieror në ethe reumatizmale dhe artitin reumatoid. <i>Ethja reumatizmale ose artriti reumatizmal akut është një sëmundje e përgjithshme e organizmit që shfaqet me temperaturë të lartë, me prekje të indit kolagen me lokalizim kryesor në kyçe dhe në zemër.</i>	<sup>(1)</sup> fq.93-99	Leksion 1 orë
	<b>Tema 11</b> - Kujdesi infermieror ne Ezofagite dhe në Kancerin e Ezofagut. <i>Kanceri ezofageal është neoplazi e ezofagut. Tumoret ezofageale zakonisht japin vështirësi në gëlltje, dhimbje dhe simptoma të tjera, dhe janë diagnostikuar me biopsi. Përveç tyre janë evidentuar edhe tumoret e vogla të cilët trajtohen me kirurgji me qëllime kurative.</i>	<sup>(1)</sup> fq.100-106	Leksion 1 orë
	<b>Tema 12</b> - Kujdesi infermieror ne Gastrit dhe ne Ca e Stomakut. <i>Gastriti është një inflamacion i mukozave të stomakut.</i> <i>Kanceri i stomakut konsiderohet si një nga patologjitë malinje të tubit tretës, por kjo gjë ndryshon sipas vendeve të ndryshme.</i>	<sup>(1)</sup> fq.107-114	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
V.	<b>Tema 13</b> - Kujdesi infermieror ne Ulceren Peptike dhe duodenale. <i>Vlerësimi i diagnozave infermiore dhe nderhyrja infermiore.</i> <i>Ulcerat është një ndërprerje e vazhdimësisë së mukozës gastrointestinale që përhapet gjatë gjithë submukozës deri në shtresën muskulare. Ulcerat peptike konstatohet në stomak, në pilor dhe në bulbin duodenal.</i>	<sup>(1)</sup> fq.115-120	Leksion 1 orë
	<b>Tema 14</b> - Kujdesi infermieror ne Pankreatite, Kalkulozen Biliare dhe Kolecistitin akut. <i>Pankreatiti akut është inflamacion i menjehershëm i pankreasit (parenkimes pankreatike) që pasohet nga lezionet duke filluar nga edema deri në nekroze indore koagulative. Pankreatiti kronik është sëmundje inflamatorë e</i>	<sup>(1)</sup> fq.121-126	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI VLORË”  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>pankreasit që karakterizohet nga demtime të parikthyeshme të indit pankreatik.</i></p> <p><b>Tema 15</b> - Kujdesi infermieror në Cirozen Hepatike dhe në Morbus Chron. <i>Cirozis është një term i përgjithshëm, që përfshin të gjitha format e demtimeve kronike të përhapura të masës së heparit.</i> <i>Morbus Chron është një sëmundje inflamatore kronike me ecuri klinike perseritese recidivante që mund të interesojë cilendo zonë të traktit tretës prej gojës deri në anus.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.</p>	<sup>(1)</sup> fq.127-137	Leksion 1 orë  <i>Praktikë 4 orë</i>
VI.	<p><b>Tema 16</b> - Kujdesi infermieror në Infeksionet e vijave urinare <i>Infeksionet urinare janë një term i cili përdoret për të përshkruar infeksionet e sistemit urinar. Këto infeksione emërtohen në varësi të vendit të zhvillimit të infeksionit.</i></p> <p><b>Tema 17</b> - Kujdesi infermieror në Kalkuloza renale, reni policistik. <i>Kalkuloza renale ose nefrolitjaza përfaqëson në vetvete prezencën e kristaleve ose të gureve në veshka ose në rrugët urinare, që vijnë si pasojë e precipitimit ose agregimit të kripave prezente në urinë në kushte normale ose patologjike. Policistoza renale është sëmundja më e shpeshtë hereditare e aparatit urinar. Sëmundja karakterizohet nga prania e kisteve të shumta në të dyja veshkat, të cilët janë të dimensioneve të ndryshme.</i></p> <p><b>Tema 18</b> - Kujdesi infermieror në Glomeronefrite dhe pielonefrite. <i>Sëmundja glomerulare karakterizohet nga një reaktion inflamator, me infiltrim të leukociteve dhe qelizash proliferative të glomerulit, si pasojë e demtimeve imune glomerulare. Nefritis është një sëmundje që karakterizohet nga inflamacioni infeksioz i glomerulit të veshkës, me prodhim të pakët të urinës, me prezencë të gjakut dhe të proteinave në urinë dhe me edema. Pielonefriti është një infeksion i rrugëve urinare që godet pielonin e veshkave. Ai prek pothuajse të gjitha strukturat e veshkave. Përjashtim bën glomeruli i cili preket vetëm në statet e avancuara të sëmundjes.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë</p>	<sup>(1)</sup> fq.138-140  <sup>(1)</sup> fq.141-147  <sup>(1)</sup> fq.147-156	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  <i>Praktikë 4 orë</i>
VII.	<p><b>Tema 19 – 20</b> - Kujdesi infermieror në I.R.A &amp; I.R.K, Dializa, llojet dhe kujdesi. <i>Insuficenca renale akute karakterizohet nga ndërprerja e papritur dhe e menjëhershme e funksioneve kryesore renale e shoqëruar me ndryshime metabolike që vijnë si rezultat i grumbullimit në organizëm të produkteve të katabolizmit proteïnik.</i> <i>IRCH është një gjëndje permanente, e parikthyeshme në të cilën veshka ndalon eliminimin e produkteve përfundimtare të metabolizmit dhe ujin e tepërt nga gjaku.</i></p> <p><b>Tema 21</b> - Kujdesi infermieror në Talasemi. <i>Talasemia është një patologji hematologjike (hemoglobinopati) e trashëguar ku ndodh një mutacion në një nga aminoacidet e Alfa ose Beta globinës të cilat çojnë në shkatërrim të shpejtë e të tepërt të eritrociteve.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë</p>	<sup>(1)</sup> fq.157-164  <sup>(1)</sup> fq.165-169	Leksion 2 orë  Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
			Praktikë 4 orë
VIII.	<p><b>Tema 22</b> - Kujdesi infermieror në Anemine drepanocitare. <i>Është një anemi e bashkëlindur mesdhetare, në themel të së cilës qëndron shformimi i eritrociteve në kushte hypoksie, drapëzimin i tyre i cili shkaktohet nga ndryshimi i pozicioneve të dy aminoacideve në kromozome për prodhimin e hemoglobinës.</i></p> <p><b>Tema 23</b> - Kujdesi infermieror në Leukozat akute dhe kronike <i>Leukozat akute dhe kronike janë sëmundje neoplazike me etiologji idiopatike, dhe prognozë mjaft të keqe. Ato përfshijnë anomali në mbiprodhimin e qelizave të bardha.</i></p> <p><b>Tema 24</b> - Kujdesi infermieror në Diabetin mellitus <i>Diabeti Mellitus është një çrregullim kronik i metabolizmit të karbohidrateve, yndyrnave dhe proteinave. Ai paraqitet klinikisht si dëmtimi ose pakësimi i prodhimit të insulinës. Mungesa relative ose absolute e insulinës çon në uljen e përdorimit të glukozës nga qelizat, rrit metabolizmin e glikogjenit në glukozë, rrit katabolizimin e proteinave dhe lipideve me funksion glukogjenik.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.170-173</p> <p><sup>(1)</sup>fq.174-178</p> <p><sup>(1)</sup>fq.179-185</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 4 orë</p>
IX.	<p><b>Tema 25</b> - Kujdesi infermieror në Hyrtiroidozat dhe Hypertiroidozat. <i>Hyperthyroidizmi është termi për ind tepër aktiv në kuadër të gjëndres tiroide duke shkakuar një prodhim të tepërt të hormoneve tiroide (thyroxine dhe /ose trijodothyronine).</i></p> <p><i>Hypothyroidizmi shtë sëmundje rezistente e shkakuar nga prodhimi i pamjaftueshëm i hormoneve tiroide nga gjëndra tiroide.</i></p> <p><b>Tema 26 -27</b> - Asepsia,antisepsia, sterilizimi, dezinfektimi. <i>Ekzistojnë procedura të veçanta për të arritur asepsinë që njihen me emrin asepsi mjekësore apo teknika pastertie. Këto procedura kryhen me qëllim parandalimin e përhapjes së mikroorganizmave patogjenë nga një individ apo vend në një individ apo vend tjetër. Asepsia mjekësore ndryshon nga dezinfektimi dhe sterilizimi.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.186-192</p> <p><sup>(1)</sup>fq.193-205</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 2 orë</p> <p>Praktikë 4 orë</p>
X.	<p><b>Tema 28</b> - Kujdesi infermieror në përgatitjen preoperatore <i>Edukimi paraoperator përfshin keshillat që mund t'i jepen të sëmurit vetëm ose në grup. Gjatë kësaj procedure infermierja duhet të flasë qetë, ngadalë dhe e sigurtë, të zgjedhë fjalët në mënyrë që pacienti të mos trembet, por në të njëjtën kohë të kuptojë ato që thuhet. Edukimi paraoperator ka për qëllim të qetësojë pacientin dhe ta përgatisë atë për intervent.</i></p> <p><b>Tema 29</b> - Kujdesi infermieror në periudhën postoperatore. <i>Rivendosja e anatomisë dhe pavarësisë së pacientit post - operator realizohet nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm në fazën e parë post – operatore (fazë gjatë së cilës organizimi është i impenjuar në ruajtjen dhe korrigjimin e homeostazës) dhe nëpërmjet terapisë mbështetëse (përshkrimi mjekësor dhe një asistence të vazhdueshme në varësi të gjendjes së pacientit dhe aktivitetit të përditshëm.</i></p> <p><b>Tema 30</b> - Kujdesi infermieror në dhimbje dhe menaxhimi i saj. <i>Dhimbja është një ndjenje e papëlqyer subjektive dhe eksperiencë personale e</i></p>	<p><sup>(1)</sup>fq.206-210</p> <p><sup>(1)</sup>fq.211-214</p> <p><sup>(1)</sup>fq.215-221</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies	
	<p><i>shoqeruar me demtime aktuale ose të mundshme të indeve.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.</p>		<i>Praktikë 4 orë</i>	
XI.	<p><b>Tema 31</b> - Kujdesi infermieror në hemorragjitë e jashtme dhe të brendshme, transfuzionet e gjakut .  <i>Me hemorragji do të kuptojmë daljen jashtë të gjakut nga sistemi në të cilin ndodhet (arterie, shtrat kapilar, vena) për shkak të një dëmtimi traumatik (p.sh nje plage), të një dëmtimi organik (p.sh nje ulcer, një tumor), ose me rrallë për shkak të një çrregullimi të koagulimit.</i></p> <p><b>Tema 32</b> - Kujdesi infermieror për plagët dhe mjekimi i tyre.  <i>Plagë quhet prishja e vijshmerisë së lëkurës, nga shkaktarë traumatik, e cila mund të prekë edhe indet e thella.</i>  <i>Mjekimet në repartin e kirurgjise janë veprime të përditshme dhe është detyrë e infermierit të kryejë mjekimet korrektësisht dhe të vëzhgojë ecurinë e plagëve kirurgjikale.</i>  <i>Korrektësisht do të thotë që kjo praktikë të kryhet me teknikë aseptike për të evituar kontaminimin dhe të manipulohet lehtë në mënyrë që të evitohen vuajtjet dhe demtimet.</i></p> <p><b>Tema 33</b> - Kujdesi infermieror në kateterizimin vezikal.  <i>Kateterizimi vezikal është tërësia e manovrave me vendosjen në vezikë të një instrumenti tubular (kateterit), në mënyrë që të sigurohet eliminimi i urinës.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq. 222-227</p> <p><sup>(1)</sup>fq.227-231</p> <p><sup>(1)</sup>fq.232-235</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>	
	XII.	<p><b>Tema 34-35.</b> Kujdesi infermieror në sondën nazo-gastrike dhe në trakeotomi.  <i>Shumë nga patologjitë e traktit gastro-intestinal kërkojnë përdorimin e tubit nazo-gastrik për të përcaktuar prezencën ose mungesën e gjakut në stomak, për të kontrolluar nivelin e hemoragjisë, për të parandaluar zgjerimin gastrik dhe të aplikojë lavazhin.</i></p> <p><b>Tema 36.</b> Kujdesi infermieror ne paracentezën abdominale dhe drenimi pleural.  <i>Paracenteza abdominale kryhet për dy qëllime, futjen në kavitetin abdominal të solucioneve dhe medikamenteve të ndryshme dhe drenimin e likidit (ascitit) që ndodhet në kavitetin abdominal (peritoneal).  Drenimi pleural është nje sistem drenimi valvular i cili parandalon hyrjen e ajrit në kavitetin pleural dhe siguron eliminimin e tij nga ky kavitet.</i></p> <p>Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgjisë.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq. 236-244</p> <p><sup>(1)</sup>fq.245-247</p>	<p>Leksion 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>
		XIII.	<p><b>Tema 37-38</b> - Kujdesi infermieror ne djegie dhe në ngrirje  <i>Djegje quhet dëmtimi i lëkurës dhe të indeve nën të si rezultat i veprimit lokal të nxehtësisë mbi sipërfaqen e trupit. Në qoftë se djegia prek një sipërfaqe të madhe atëhere përveç dëmtimeve lokale shfaqen edhe çrregullime të përgjithshme. Këto të fundit janë të kushtëzuara nga humbja e likideve, albuminave, elektroliteve etj.</i></p> <p><b>Tema 39</b> - Kujdesi infermieror ne pacientet ne gjendje shoku  <i>Eshtë një gjendje klinike dramatike që karakterizohet nga rënie akute e përfuzionit në nivelin kapilar që shërohet me pakësim të oksigjenimit indor, pakësim të funksionit qelizor dhe evolim të këtyre çrregullimeve drejt vdekjes.</i></p>	<p><sup>(1)</sup>fq. 248-253</p> <p><sup>(1)</sup>fq. 253-256</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Karakteristike e përbashkët e gjendjes së shokut është rënia e presionit arterial sistolik në vlera më pak se 70 - 80 mg Hg.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.</p>		<i>Praktikë 4 orë</i>
XIV.	<p><b>Tema 40</b> - Objekti i studimit të geriatriisë dhe gerontologjisë. Abuzimi mbi të moshuarin, mjedisi dhe roli i tij. <i>Geriatra është shkencë mjekësore, që merret me mjekimin e sëmundjeve të plakjes. Ka shumë rëndësi që në këtë përkufizim të dallojmë "procesin normal të plakjes" dhe kufirin midis "shëndetit të mirë" dhe sëmundjeve të të moshuarit, gjë që përbën lidhjen me gerontologjinë. Gerontologia është shkencë mjekësore, që studion procesin e plakjes. Zakonisht, është e veshtirë të caktohet ku ndërpriten proceset e "plakjes normale" dhe ku fillojnë "patologjikat".</i></p> <p><b>Tema 41</b> - Strukturat shëndetësore geriatrike, funksionimi i tyre. <i>Organizimi i strukturave geriatrike varet nga niveli i zhvillimit dhe mendësia e shoqërisë.</i></p> <p><b>Tema 42</b> - Patologjitë tek të moshuarit. Osteoporozë. <i>Osteoporozë është një patologji që ndeshet në 30-40 % të të gjithë të rriturve mbi moshën 60 vjeç.</i> <i>Indi kockor është në ndërtim të vazhdueshëm. Në kushte normale ka një ekuilibër midis proceseve, që shkatërrojnë kockën dhe atyre, që e ndërtojnë atë. Humbja e masës kockore fillon si tek burri dhe tek gruaja pasi kanë kaluar 35 vjeç dhe theksohet në menopauzë e pas saj.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë</p>	<p><sup>(1)</sup>f.q. 257-259</p> <p><sup>(1)</sup>f.q.259-260</p> <p><sup>(1)</sup>f.q. 258-264</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>
XV.	<p><b>Tema 43</b> - Neurologjia geriatrike. <i>Parkinsoni, Demenca dhe Alzheimeri.</i></p> <p><b>Tema 44</b> - Kanceri i Prostatës. Problemet e inkontinencës tek të moshuarit. Postmenopauza. <i>Me kalimin e viteve një mashkull ka mundësi më të mëdha për të zhvilluar këtë tumor, por nuk janë identifikuar akoma faktorët që e shkaktojnë atë.</i></p> <p><b>Tema 45</b> - Problematika asistencialë tek të moshuarit. Parimet e asistencës geriatrike. Kujdesi parandalues në geriatri. Mesazhe të Edukimit Shëndetësor. <i>Plakja normale nuk nën kupton domosdoshmërisht një gjendje patologjike ose varësie nga sëmundjet kronike (80% e të moshuarve mbi 65 vjeç kanë shëndet të mirë dhe bëjnë jetë aktive, të pavarur, por 20% e tyre paraqesin patologji, që kufizon pavarësinë personale). Problemet asistencialë të të moshuarve nënkuptojnë rritje të sëmundshmërisë, mbizotërim të sëmundjeve kronike, invaliditet të rëndësishëm funksional.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë</p>	<p><sup>(1)</sup>f.q.264-279</p> <p><sup>(1)</sup>f.q. 278-282</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

<b>FREKUENTIMI:</b>	Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të
---------------------	--



REPubLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

		<p>zëvendësohet në marrvëshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).</p> <p>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>				
<b>KONTROLLI I VAZHUESHËM</b>	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provim i pjesshem	Java7-8	1-15	30 pike	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Provimi final	Fundi i semestrit	Gjithë lënda	60 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Gjate semestrit	-	10 pikë	Realizim teknikash infermierore	Demonstrim procedure në përkujdesjen infermierore
	*Vlerësim i vazhduar - Do të realizohet prej pedagogut të praktikës për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të demonstrojnë në mënyrë periodike teknikat infermierore pranë pacientit në repartin e patologjisë dhe kirurgjisë.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	

<b>LITERATURA</b>	
<b>Literatura bazë</b>	1. <b>"Infermiera speciale tek adulti"</b> : -E.Alushi,S.Nika 2012 (FSHP-UV) Ribotim2017 ISBN97899956-91-89-9
<b>Literatura e rekomanduar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ 'Infermiera ne Specialitete' –E.Peka,L.Necaj,E.Rustami,D.Bego, (Fakulteti i Infermierisë - UT)</li> <li>○ A.Imami-Lelçaj,M.Cela,A.Dervishi,V.Zanaj,V.Mane Tirane 2005</li> <li>○ Kaplan Nursing.The Basics-Firth Edition-Veronica Philips arikian,Joanne Brown, Judith A.Aburckhardt –Kaplan 2006</li> </ul>

<b>VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS</b>	
<b>Dispozita:</b>	<p>Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuar.</p>





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualetit nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnje burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.